



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1235/6 prot.

Tiranë, më 16.07.2025

REKOMANDIM

Nr. 37, datë 16.07.2025

PËR KONTROLLUESIN “DENTAL CARE CLINIC”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Dental Care Clinic”, Tiranë (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 79, datë 17.04.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Zbatim i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi ushtron aktivitetin si klinikë stomatologjike në zbatim të ligjit nr. 9928, datë 09.06.2008 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”.

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “pacientë”; “staf administrativ”; “mjek”; “infirmier”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka të publikuar “*Politikat e Privatësisë*” në faqen e internetit <https://www.dentalcareclinic.al>. Subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje), etj, në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ka detyrim që të publikojë “*Politikën e Privatësisë*” dhe të informojë qartësisht subjektet e të dhënave, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes së internetit.

3. Kontrolluesi nuk disponon “*Rregullore për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash) sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative etj, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të tij.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregullore specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura teknike-organizative mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, (për çdo kategori subjektesh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 28 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

4. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit “*Deklaratën e Konfidencialitetit*”, në përmbushje të detyrimit ligjor që buron nga neni 30 i Ligjit si dhe të Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*”, (në vijim, “*Vendimi nr. 6*”),

Zyra e Komisionerit vlerëson se, qëllimi i nënshkrimit të “*Deklaratës së Konfidencialitetit*” është që të gjithë punonjësit, të cilët kanë akses në të dhënat personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë, detyrimet dhe përgjegjësitë që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

5. Kontrolluesi përpunon të dhëna sensitive të pacientëve, megjithatë rezulton se nuk ka emëruar një nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, caktimi i një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim i rëndësishëm që ka për qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese që realizohen nga ana e Kontrolluesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Gjithashtu, bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit në rastin e caktimit të një nëpunësi të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas këtij Ligji

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, si dhe i është lënë afat të depozitojë pretendimet me shkrim, referuar procesverbalit të hartuar nga ana e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 30.06.2025, ka shprehur dakordësinë lidhur me konstatimet e grupit të hetimit dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si dhe ka vendosur në dispozicion dokumente si më poshtë vijon:

- a) Protokoll për menaxhimin e informacionit nga personeli shëndetësor;
- b) Rregullore për dhënien e autorizuar të të dhënave personale jashtë klinikës;
- c) Rregullore e përdorimit të të dhënave ndaj palëve të treta;
- d) Deklaratë konfidencialiteti;
- e) Urdhër i brendshëm mbi krijimin e komitetit për mbrojtjen e të dhënave personale:

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 13, 28, 30, 33 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për publikimin e “*Politikave të Privatësisë*” në faqen e internetit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;

2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 30 të Ligjit, të aplikojnë “Deklaratën e Konfidencialitetit” me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale;
4. Kontrolluesi të marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 34 të Ligjit, si dhe të njoftojë Zyrën e Komisionerit për caktimin e tij;
5. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1 dhe 3 më sipër;
 - (ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 2 dhe 4 më sipër;Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
6. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
7. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri, bazuar në germën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast shkeljesh serioze ose të qëllimshme të dispozitave ligjore, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 16.07.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi